

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-201/15

**Prishtinë,
14 Shkurt 2018**

Në çështjen juridike të:

B. S.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje “KKPK”) KPCC/D/R/255/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA56110), të datës 27 gusht 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 14 Shkurt 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga B. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/255/2014, të datës 27 gusht 2014, lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numër KPA56110, refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/255/2014, i datës 27 gusht 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numër KPA56110, vërtetohet.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 27 dhjetor 2007, B. S. (tani e tutje: “pala ankuese”) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje: AKP) duke kërkuar vërtetimin e të drejtave pronësore dhe ri-posedimin e banesës me sipërfaqe prej 65.08 m², e cila gjendet në rrugën “Bregu i diellit” Nr. II, objekti Nr. 40, hyrja nr. II, kati nr. 2, Komuna e Prishtinës (tani e tutje: prona e kërkuar).
2. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
 - Aktvendimin Nr. 01-185/2 për ndarjen e përgjithshme të 42 banesave të solidaritetit në shfrytëzim në vendin e quajtur Bregu i Diellit, i lëshuar më 12 qershor 1998 nga Fondi për financimin e ndërtimit të banesave të solidaritetit, ku figuron se prona e kërkuar është në listë,
 - Vendimin mbi ndarjen e banesës së solidaritetit në shfrytëzim Nr. 360/99, të lëshuar nga Administrata e të Hyrave Publike e Republikës së Serbisë më 18 janar 1999, me të cilin, palës ankuese në cilësi të punëtores së Administratës së të Hyrave Publike me qendrën e saj në Prishtinë i është ndarë prona e kërkuar në shfrytëzim,
 - Kontratën mbi qiranë e banesës Nr. 25 të lidhur më 21 janar 1999 midis Ndërmarrjes Publike në Prishtinë dhe palës ankuese, në lidhje me pronën e kërkuar,
 - Kontratën mbi shitjen e banesës të vërtetuar më 18 mars 1999 pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës me numër të referencës Nr. 2100/99. Kontrata është lidhur midis Administratës të të Hyrave Publike–Qendrës në Prishtinë në cilësi të shitësit dhe palës ankuese në cilësi të blerësit të pronës së kërkuar.

3. Më 9 korrik 2008, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka bërë njoftimin e pronës së kërkuar. Prona e kërkuar është gjetur të jetë e zënë nga Sh.G, mirëpo ai nuk ka kërkuar asnjë të drejtë mbi pronën e kërkuar.
4. Pasi që asnjë palë nuk ka paraqitur përgjigje ndaj kërkesës brenda afatit prej 30 ditësh sipas nenit 10.2 të Ligjit Nr. 03/L-079, kërkesa është konsideruar si jokontestuese.
5. Sipas raportit të verifikimit të Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së, vendimi mbi ndarjen e banesës së solidaritetit në shfrytëzim Nr. 360/99, si dhe kontrata e shitjes së banesës e vërtetuar më 18 mars 1999 pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës me numër të referencës Nr. 2100/99, nuk është gjetur tek institucionet kompetente, prandaj, verifikimi i këtyre dokumenteve ka rezultuar negativ.
6. AKP-ja ka vërtetuar se banesa më parë i është nënshtruar gjykimit nga KKPB-ja me kërkesë të palës ankuese. Kërkesa është hedhur poshtë nga KKPB-ja me anë të vendimit nr. HPCC/D/154/2004/C të datës 22 tetor 2004. Sipas paragrafëve 11, 12 dhe 18 të vendimit grupor i cili vlen posaçërisht për kërkesën, dokumentet e paraqitura nga S. duket të mos jenë të vërteta. Zyrtarët e Drejtoratit kanë bërë përpjekje për t'i verifikuar dokumentet pranë zyrave përkatëse publike, mirëpo asnjëri nga dokumentet e paraqitura nuk kishte një kopje origjinale korresponduese të referencës në regjistrin e bartësve përkatës të së drejtës së ndarjes, Ndërmarrja Publike Banesore dhe Gjykata Komunale kompetente. Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë dokument provë të verifikuar për të vërtetuar se e ka pasur në posedim pronën në fjalë, apo ndonjë provë për të drejtën pronësore, e cila i jepte të drejtën e marrjes në posedim të pronës së kërkuar, rrjedhimisht kërkesa duhet të hedhet poshtë.
7. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga KKPB-ja me anë të vendimit HPCC/REC/76/2006 të datës 18 tetor 2006. Në paragrafin 30 të vendimit grupor i cili sipas vendimit të certifikuar vlen posaçërisht për kërkesën, thuhet se paraqitësi i kërkesës së kategorisë C (pala ankuese në rastin në fjalë), kërkon hetimin e duhur të rastit të tij duke pretenduar se ekzistojnë dokumente të vlefshme në lidhje me pronën e kërkuar. Komisioni ka bërë hetime plotësuese në arkivin e zhvendosur në Nish dhe asnjë dokument i tillë në emër të palës ankuese nuk është gjetur. Drejtorati gjithashtu ka bërë hetime edhe një herë pranë Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë. Ata kanë marrë një listë me emra të shfrytëzuesve të banesave në ndërtesën në fjalë dhe në këtë dokument nuk përmendet emri i palës ankuese.
8. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ka kontaktuar palën ankuese dhe i ka kërkuar dokumente plotësuese për ta vërtetuar të drejtën pronësore të pretenduar mbi pronën e kërkuar. Sipas shënimeve në dosjen e AKP-së, ai është njoftuar se dokumentet të cilat i ka dorëzuar lidhur me këtë nuk janë gjetur në të dhënat publike, dhe i është dërguar një njoftim për papranueshmërinë potenciale duke i kërkuar atij që t'i paraqes dokumentet e kërkuara (faqe nr. 171 të shkresave të lëndës). Pala ankuese ka paraqitur dokumentet e njëjta të cilat tashmë janë shqyrtuar nga KKPB-ja paraprakisht dhe është gjetur se nuk janë të vërteta. Ai ka konfirmuar se nuk ka dokumente të tjera për t'i dorëzuar.

9. Më 27 gusht 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), me anë të vendimit KPCC/D/R/255/2014, ka refuzuar kërkesën. Në paragrafin 35 dhe 36 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të certifikuar posaçërisht vlen për kërkesën, thuhet se dokumentet të cilat i ka dorëzuar pala ankuese, nuk janë verifikuar nga Sekretariati Ekzekutiv si të vërteta. Më tutje, paraqitësi i kërkesë ka dorëzuar deklarata me shkrim të dhëna nga tre dëshmitarë, duke konfirmuar se prona e kërkuar i është ndarë palës ankuese. Sipas mendimit të komisionit, kjo deklaratë, në mungesë të dokumenteve prova vërtetuese, nuk është provë e mjaftueshme për të vërtetuar pronësinë mbi pronën e kërkuar. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet.
10. Më 19 nëntor 2014, vendimi i është dorëzuar palës ankuese, dhe ai ka paraqitur ankesë pranë Gjykatës Supreme më 19 dhjetor 2014

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese e kundërshton vendimin duke theksuar se bazohet në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në zbatim të gabuar të ligjit material.
12. Pala ankuese insiston se fakti që komisioni nuk ka qenë në gjendje t'i verifikojë pozitivisht dokumentet e dorëzuara nga ai, nuk është i vërtetë. Institucionet pranë të cilave duhet të verifikohen dokumentet i posedojnë provat në bazë të cilave mund të vërtetohet e drejta pronësore në emër të tij.
13. Pala ankuese ka kërkuar dëshmi nga institucionet kompetente se dokumentet nuk janë lëshuar nga ato institucione.
14. Më tutje, pala ankuese thekson se ai e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në qershor 1999 kur është detyruar që të largohet nga prona për shkak të rrethanave të njohura.
15. Në fund, pala ankuese pret nga Gjykata Supreme që ta korrigojë gabimin dhe të lëshojë vendim të drejtë duke konfirmuar se palës ankuese i takon e drejta për ri-posedim të pronës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor

16. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç është paraparë me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079, dhe është e pranueshme.
17. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të parashtrësave në shkresat e lëndës, vendimit të kundërshtuar dhe pretendimeve në përputhje me nenin 194 të LPK, ka gjetur se ankesa është e pabazuar.
18. Në fakt, pala ankuese paraprakisht ka aplikuar në KKPB duke kërkuar ri-posedimin e pronës së kërkuar, e cila pretendohet të jetë humbur gjatë konfliktit. KKPB-ja me vendimin

HPCC/D/154/2004/C, të datës 22 tetor 2004, ka hedhur poshtë kërkesën sepse paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dokument provë të verifikuar për ta vërtetuar se ka pasur ndonjëherë në posedim pronën në fjalë.

19. Nuk është kontestuese që pala ankuese në mënyrë të qartë ka kërkuar ri-posedimin e pronës së kërkuar pranë KKPb-së. Sidoqoftë, për të paraqitur kërkesë në mënyrë të vlefshme në procedurën e parë, neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe neni 1.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 të cilave i referohen në nenin 7.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, kërkon që pala ankuese të jetë posedues i pronës së kërkuar para 24 marsit 1999.
20. Për ta vërtetuar të drejtën e tij të posedimit, pala ankuese i ka dorëzuar KKPb-së të **njëjtat dokumente** të përshkruara në pjesën e përmbledhjes së çështjeve faktike dhe procedurale të aktgjykimit. Këto dokumente nuk kanë mundur të verifikohen nga KKPb-ja pranë gjykatës kompetente në Kosovë.
21. Me vendimin HPCC/REC/76/2006 të datës 18 tetor 2006, kërkesa për rishqyrtim kundër vendimit HPCC/D/154/2004/C, e paraqitur nga pala ankuese është refuzuar. Kjo do të thotë se vendimi HPCC/D/154/2004/C është i formës së prerë dhe nuk mund të ankimohet.
22. Pala ankuese nuk ka sjellë asnjë provë të re që shpjen KKPK-në që ta mohojë këtë verifikim, prandaj, gjendja faktike e paraqitur në komision nga pala ankuese ka qenë e njëjtë, sidoqoftë e drejta pronësore mbi banesën nuk është shqyrtuar nga DPB, kështu, duke ia mundur palës ankuese që t'i përmbush kushtet në procedurën pranë AKP-së, ndërsa ai ka kërkuar të drejtën pronësore dhe ri-posedimin e banesës.
23. Në lidhje me lëndën në fjalë të paraqitur pranë AKP-së, KKPK-ja e ka bazuar vendimin e tij në faktin se Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së dhe KKPK-ja përsëri kishin bërë verifikim negativ të dokumenteve në të cilat pala ankuese e bazon kërkesën tij për pronësi. Sekretariati Ekzekutiv i KKPK-së nuk ka qenë në gjendje të marrë *sipas detyrës zyrtare* asnjë provë që mbështet kërkesën e palës ankuese. Kjo do të thotë se të njëjtat dokumente janë verifikuar dy herë nga KKPb-ja (HPCC/D/154/2004/C datë 22 tetor 2004 dhe HPCC/REC/76/2006 datë 18 tetor 2006) dhe përsëri nga KKPK-ja më 27 gusht 2014 KPCC/D/R/255/2014 që e çon verifikimin në të njëjtin përfundim që është negativ.
24. Ankesa e palës ankuese i përsërit pretendimet e njëjta të bëra pranë KKPb-së dhe KKPK-së.
25. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, bazuar në një procedurë të plotë dhe korrekte. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjen se nuk është bërë asnjë shkelje e ligjit material apo vërtetim i gabuar i fakteve.
26. Në bazë të asaj që u tha më lart, në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Ragip Namani, gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, referent i EULEX-it